



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PËRMBARIMIT "BEST 2010"

Nr.160/6.prot

Datë, 24 dhjetor 2018

URDHËR

Lënda: Anullim i urdhrit të Përmbaruesit

Drejtuar: Qendrës Kombëtare të Biznesit

I nderuar drejtor,

Unë Saimir Hoxha, Përmbaruesi Gjyqësor, pasi studiova dokumentacionin që i përket Urdhrit të Ekzekutimit nr. 644, datë 09.10.2018 të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës,

KONSTATOVA:

Se pranë kësaj zyre përmbarimi është depozituar kërkesa e kreditorit për zbatimin e titullit ekzekutiv (fatura tatimore nr. 173, datë 10.08.2015) me palë e objekt:

-**Kreditor:** Shoqëria "Alushi-Trans"Sh.p.k

-**Debitor:** Shoqëria "Novo Sapac Energie"Sh.p.k (Nuis: L32402010B, Adm.Besim Mulaj)

-**Objekti:** Detyrim monetar

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga bisedimet me palën debitorë rezulton që sekuestro që iu kemi kërkuar me urdhrin nr. 160/4, datë 05.11.2018 është e panevojshme.

Pra duhet të revokohet/anullohet nga kjo zyrë urdhri nr. 160/4, datë 05.11.2018.

Për sa më sipër bazuar në nenet 519 e në vijim të K.Pr.C e në nenin 46 i ligjit nr.10031, dt.11.12.08 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor" i ndryshuar,

JU KËRKOJ QË:

1- Të konsideroni të anuluar urdhrin e kësaj zyre përmbarimore nr.160/4, datë 05.11.2018;

2- Të më informoni për veprimet tuaja brenda afateve ligjore.

Faleminderit për bashkëpunimin/mirëkuptimin

PËRMBARUESI GJYQËSOR

SAIMIR T. HOXHA

Zyra e Përmbarimit "BEST 2010"

Adresa: prapa Prokurorisë Rrethit Durrës

Tel/Fax: 052- 22 6000;

E-mail: BEST.2010@PERMBARUES.AL